

**Balkan Green Foundation (BGF)
Lëvizja FOL (FOL)
Open Data Kosovo (ODK)**

Projekti Kosovo Green Action

Plani i angazhimit të palëve të interesit (SEP)

13 dhjetor 2022

1. Shkurtesat

BGF	Balkan Green Foundation
OSHC	Organizatat e shoqërisë civile
ESF	Korniza mjedisore dhe sociale
FoI	Liria e Informacionit
FOL	Lëvizja FOL – FOL Movement
QK	Qeveria e Kosovës
MA	Mekanizmi i ankesave
GPSA	Partneriteti global për përgjegjshmëri sociale
KGA	Kosovo Green Action
MM	Memorandum Mirëkuptimi
OJQ	Organizatat joqeveritare
ODK	Open Data Kosovo
SEP	Plani i angazhimit të palëve të interesit
BB	Banka Botërore

2. Hyrje/Përshkrim i projektit

2.1. Hyrje

Ky Plani i angazhimit të palëve të interesit (SEP) për projektin e Kosovo Green Action është përgatitur nga Balkan Green Foundation, Lëvizja FOL dhe Open Data Kosovo në përputhje me Standardin mjedisor dhe social të Bankës Botërore për angazhimin e palëve të interesit dhe shpalosjen e informatave (ESS10). Në të përcaktohet programi për angazhimin e palëve të interesit, duke përfshirë shpalosjen e informatave publike dhe konsultimin, gjatë gjithë ciklit të projektit, përshkruhen mënyrat në të cilat ekipi i projektit do të komunikojë me palët e interesit dhe përfshihet një mekanizëm me të cilin njerëzit mund të ngrënë shqetësime, të japin komente ose të paraqesin ankesa për projektin dhe çdo aktivitet që lidhet me të.

2.2. Përshkrimi i projektit dhe rreziqet

2.2.1 Përshkrimi i projektit

Projekti Kosovo Green Action synon të mbështesë Qeverinë e Kosovës dhe palët tjera kyçe të interesit për të përsheptuar zbatimin e Agjendës së Gjelbër përmes aktiviteteve që përmirësojnë qasjen në informacion, llogaridhënien, transparencën dhe qeverisjen e mirë, fuqizojnë të rinjtë, si dhe nxisin veprimet për klimën. Më konkretisht, ka për synim i) të zhvillojë kapacitetet e qeverisë për të përmirësuar politikëbërjen e mbështetur nga të dhënat në përputhje me Agjendën e Gjelbër; ii) të nxisë bashkëpunimin dhe dialogun ndërmjet institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile (OSHC), mediave dhe qytetarëve në çështjet kyçe të Agjendës së Gjelbër; dhe iii) të angazhojë palët e interesit përmes mekanizmave të ndryshëm, duke përfshirë një platformë digjitale ndërvepruese dhe të udhëhequr nga të dhënat për çështjet e lidhura me klimën/energjinë, për informim, veprim dhe ndërveprim me subjektet qeveritare për zotimet për klimën dhe energjinë (përfshirë përgjegjshmërinë sociale). Për më tepër, projekti synon të rrisë vetëdijen e publikut për çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike përmes trajnimeve, debateve publike, etj. Shtrirja gjeografike e projektit është në të gjithë vendin, duke mbuluar shtatë rajonet administrative të Kosovës.

Projekti i Kosovo Green Action do të përbëhet nga tri komponentë:

Komponenti 1: Zhvillimi dhe mbështetja për përgjegjësi sociale bashkëpunuese. Ky komponent përqendrohet në veprimet me të cilat do të vlerësohet situata aktuale dhe të krijohet skena për aktivitete me të cilat do të zhvillohen intervenime në llogaridhënie sociale gjatë zbatimit të projektit. Së pari, konsorciumi i OSHC-ve do të kryejë kërkime për të thelluar fokusin e projektit dhe, së bashku me aktorët kryesorë, për të identifikuar çështjet kryesore prioritare, zgjidhjet dhe rekomandimet që duhen mbështetur. Po ashtu, ky komponent do të sjellë bashkë-zhvillimin e një platforme gjithëpërfshirëse online. Takimet konsultative do të shërbejnë si gur themel për të rritur llogaridhënien kolektive sociale duke përfshirë të gjithë aktorët përkatës dhe duke formësuar hartimin dhe zhvillimin e funksionimit të platformës në prapavijë (back-end) dhe pjesës ballore të saj (front-end), duke përfshirë ndërfaqen (interface) miqësore për përdoruesit dhe funksionin “pyet shtetin”. Kjo veçori e integruar brenda platformës do t'i udhëzojë përdoruesit që me lehtësi të parashtrajnë kërkesat për Lirinë e Informacionit (Fol) për dokumente publike. “Pyet shtetin” është një opsion i lehtë që nëpërmjet platformës t'i bëhen pyetje specifike ministrive të linjës drejtpërdrejtë për të mbledhur informacion në lidhje me çështjet e energjisë dhe klimës.

Komponenti 2: Angazhimi i palëve të interesit dhe ndërtimi i kapaciteteve për llogaridhënie sociale bashkëpunuese. Ky komponent fokusohet në zbatimin e mekanizmave të llogaridhënies sociale të

dizajnuara dhe të pilotuara brenda objektit të komponentit të parë të këtij projekti dhe në rritjen e intervenimeve që mobilizojnë aktorët kryesorë në marrjen e vendimeve të koordinuara dhe të bazuara në të dhëna. Synon krijimin e platformave për angazhim ndërmjet të gjithë aktorëve të identifikuar përmes aktiviteteve të tilla si propozimin e Forumeve të Gjelbra vjetore, si një kanal për vlerësimin nga shumë palë të interesit dhe prioritizimin e progresit të Agjendës së Gjelbër, edukimit klimatik dhe angazhimit të rinjve, veçanërisht përmes debateve të gjelbra, dhe rritjen e kapaciteteve për zyrtarët publikë, përfaqësuesit e mediave dhe OSHC-të për të dhënat dhe intervenimet e bazuara në dëshmi. Projekti do të rrisë kapacitetin e gazetarëve për të transmetuar njohuri qendrore nga prioritetet tematike të Agjendës së Gjelbër të formësuar nga Platforma Online dhe kërkimi duke mbështetur ndarjen e tregimeve me të dhëna.

Komponenti 3: Menaxhimi i projektit, monitorimi dhe mësimi, dhe shpërndarja e dijes. Objektivat e këtij komponenti janë a) rritja e transparencës së të dhënave për publikun mbi statusin e legjislacionit dhe mekanizmat që mund të shfrytëzohen prej tyre për të çuar përpara zbatimin e Agjendës së Gjelbër. Do të monitorohen strategjitë e ndryshme të lidhura me klimën, të dhënat/burimet e disponueshme të lëshuara në mënyrë proaktive nga institucionet publike dhe ato që do të kërkohen të bëhen të qasshme për publikun dhe do të ofrohen analiza dhe rekomandime që do të përdoren si bazë për diskutimet e gjelbra dhe veprime të tjera komunikimi. Objektivi b) është krijimi i një procesi të brendshëm njohurish dhe mësimesh për të përshtatur rregullisht zbatimin e projektit bazuar në përvojën dhe rrethanat kontekstuale, dhe për të gjeneruar njohuri dhe për të mësuar për shpërndarjen e jashtme të synuar midis palëve kryesore të interesit që mund të marrin mësim nga projekti për të aplikuar, mbështetur ose shkallëzuar përgjegjësinë sociale bashkëpunuese dhe/ose për të formësuar vendimet thelbësore.

Gjatë gjithë projektit, konsorciumi do të monitorojë, evaluojë dhe vlerësojë zbatimin e rregulloreve dhe planeve të veprimit që lidhen me sektorin e energjisë dhe klimës. Të dhënat në dispozicion nga sektori i klimës dhe energjisë do të mbledhen dhe vizualizohen, dhe, pasi të identifikohen zbrazëtitat në të dhëna, do të avokohet dhe krijohen partneritetet për të krijuar praktika të qëndrueshme të mbledhjes së të dhënave dhe prodhimit të të dhënave të përpunueshme. Këto veprime do të ofrojnë inputet kryesore që do të shërbejnë si bazë për aktivitetet e tjera të projektit. Informacioni nga ky aktivitet do të shërbejë në përcaktimin e temave për kërkime dhe forume të gjelbra. Analiza e kontekstit e kombinuar me informacionin mjedisor dhe mapimin e palëve të interesit që do të kryhet nga projekti, gjatë fazës fillestare të tij, do të formësojë metodologjinë dhe studimin bazë.

Brenda këtij komponenti do të themelohet dhe mirëmbahet një Komiteti Drejtues gjatë gjithë zbatimit të projektit. Komiteti do të përbëhet nga përfaqësues të konsorciumit të OSHC, institucionet publike partnere, ekipi i Bankës Botërore/GPSA dhe donatorët relevant. Roli i Komitetit Drejtues do të jetë të udhëzojë drejtimin strategjik dhe aktivitetet e projektit dhe të propozojë rekomandime për fuqizimin e zbatimit të projektit dhe bashkëpunimin e palëve kryesore të interesit. Komiteti mund të përfshijë organizata të tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare për të siguruar sinergji. ToA i GPSA inkurajon krijimin e kompakteve me shumë palë të interesit, siç është Komiteti Drejtues i propozuar, për të lehtësuar efektivitetin e përgjegjshmërisë sociale bashkëpunuese duke avancuar pjesëmarrjen e grupeve të palëve të interesit të përshtatshme për qëllimin në diskutimin e rregullt të masave korrigjuese.

2.2.2 Rreziqet mjedisore dhe sociale

Të rinjtë që marrin pjesë në debatet *me temë të gjelbër* dhe hartimin e zgjidhjeve *për tema të lidhura me klimën* të përzgjedhura nga komisioni, do të shpërblehen për idetë më kreative të përdorimit të të dhënave dhe zgjidhjet teknike për avancimin e Agjendës së Gjelbër në Kosovë. Më konkretisht, ekipit fitues do të

shpërblehet me instalim të një paneli diellor në shkollën e tyre. Nga ky investim, në shkallë të vogël priten të ndodhin ndikime mjedisore të ulëta, afatshkurtra, lokale dhe reversibile, si rritja e zhurmës, pluhurit dhe ndotjes gjatë një periudhe të shkurtër të instalimeve. Këto ndikime të vogla mund të zbuten lehtësisht me zbatimin e masave të përcaktuara në Planin e angazhimit mjedisor dhe social të huamarrësit (ESCP) dhe këtë SEP.

Rreziqet dhe ndikimet e mundshme sociale lidhen kryesisht me kushtet e punës dhe të punuarit, shëndetin dhe sigurinë në punë (SHSP), shëndetin dhe sigurinë e komunitetit dhe angazhimin e palëve të interesit. Këto rreziqe dhe ndikime potenciale sociale përfshijnë: a) ndikimet në shëndet, siguri dhe mirëqenie të punëtorëve të drejtpërdrejtë dhe të kontraktuar, duke përfshirë ekspozimin ndaj COVID-19 dhe rreziqet e SHSP që lidhen me instalimin e paneleve diellore; b) rreziqet e shëndetit dhe sigurisë së komunitetit mund të ndodhin si pjesë e ngjarjeve publike të projektit për shkak të ekspozimit ndaj sëmundjeve ngjitëse si COVID-19 dhe rreziqeve për komunitetin që rrjedhin nga punimet e instalimit të paneleve diellore (p.sh. zhurma, pluhuri, ndotja, etj.); dhe c) mospërfshirja eventuale e disa grupeve si rezultat i zbatimit joadekuat të proceseve të angazhimit të palëve të interesit dhe përhapjes së informacionit. Këto rreziqe sociale që lidhen me ndërhyrjet e projektit vlerësohen të jenë të ulëta dhe pritet të zbuten me lehtësi me zbatimin e masave të përcaktuara në ESCP dhe SEP. Rreziqet e Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit/Ngacmimit Seksual janë po ashtu të ulëta, pasi aktivitetet e projektit përqendrohen në përpjekjet për kontakt me publikun/përfshirje, si dhe në instalimin e paneleve diellore në shkallë të vogël nga subjektet lokale.

Konsorciumi do të bashkëpunojë ngushtë me drejtoritë komunale të arsimit, drejtorët e shkollave dhe OJQ-të lokale që punojnë me të rinjtë (përfshirë grupet joformale të të rinjve) para dhe gjatë instalimeve të paneleve diellore për të informuar me kohë komunitetet e prekura (përfshirë prindërit dhe nxënësit) për aktivitetet e planifikuara, rreziqet e mundshme dhe masat e sigurisë. Për më tepër, thirrja për aplikime për kontraktimin e kompanisë për instalimin e paneleve diellore do të marrë parasysh rreziqet e identifikuar dhe të gjithë punëtorët e kontraktuar (dhe të tjerë) do të informohen për procedurat e menaxhimit dhe zbutjes së rrezikut, udhëzimet e sigurisë dhe mekanizmat e ankesave përpara nënshkrimit të kontratës. Publikimi i thirrjes për propozime nga ofruesit e shërbimeve do të përfshijë gjithashtu një dokument në formë deklarate që konfirmon të kuptuarit e tyre për këto rreziqe dhe se ata marrin përgjegjësinë e plotë në rast të incidenteve të mundshme.

Zbutja e rreziqeve do të udhëhiqet nga një listë kontrolli e përgjithshme e Planit të Menaxhimit Mjedisor (PMM) që do të përgatitet përpara prokurimit të punimeve ndërtimore dhe kontraktorët nga të cilët të kërkohet të përgatisin listën kontrolluese specifike të PMM. Duke marrë parasysh rëndësinë e tyre të vogël, nuk konsiderohet i nevojshëm asnjë vlerësim i mëtejshëm i rreziqeve të mundshme mjedisore dhe sociale (M&S) që rezultojnë nga projekti. Projekti do të monitorojë dhe zbusë rreziqet e vogla të identifikuar nga M&S bazuar në angazhimet e përshkruara në ESCP të Huamarrësit dhe SEP. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet sigurimit të shqyrtimit dhe menaxhimit adekuat të ndikimeve negative të M&S që mund të bien mbi grupet e cenuara, veçanërisht në lidhje me identifikimin e barrierave që kontribuojnë në mospërfshirjen e tyre në aktivitetet e projektit dhe sigurimin e mjeteve për tejkalimin e kësaj. Konsorciumi i OSHC cakton një person qendror për mbikëqyrjen e çështjeve sociale dhe mjedisore dhe për të zbutur rreziqet e mundshme sociale dhe mjedisore në përputhje me Kornizën mjedisore dhe sociale (ESF). Për më tepër, specialistët mjedisor dhe social të BB-së do të ofrojnë mbështetje për konsorciumin në menaxhimin dhe raportimin e rreziqeve sociale dhe mjedisore në përputhje me ESF-në.

3. Përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve të mëparshme të angazhimit të palëve të interesit

Diskutimet mbi dizajnimin e Projektit, duke përfshirë strategjinë përfundimtare të synuar, janë zhvilluar ndërmjet tre organizatave zbatuese dhe Bankës Botërore. Ky SEP është përgatitur si një pikënisje e një procesi angazhimi të përsëritur me aktorët përkatës të projektit. Pas konsultimit me palët e interesit për SEP, qasja e propozuar e angazhimit të palëve të interesit do të rishikohet sipas nevojës. Megjithatë, të gjitha organizatat e projektit kanë pasur përvojë të mëparshme shkëmbimi/komunikimi dhe pune me palët kryesore të interesit të projektit, përkatësisht me përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Një takim konsultativ për SEP do të mbahet me hisedarët përkatës të qeverisë, rrjetet rinore dhe OSHC-të, për të diskutuar mbi aktivitetet e projektit, objektivin dhe qasjen e angazhimit të palëve të interesit. Më pas, takimet me palët kryesore të interesit të qeverisë janë planifikuar të mbahen menjëherë pas inicimit të projektit (d.m.th. gjatë janarit). Këto takime do të shërbejnë për të diskutuar qëllimin e përgjithshëm të projektit, Memorandumin e Mirëkuptimit (MM) që do të nënshkruhet dhe angazhimin dhe bashkëpunimin e planifikuar gjatë gjithë zbatimit të projektit.

4. Identifikimi dhe analiza e palëve të interesit

Palët e interesit të projektit përfshijnë individë, grupe ose entitete të tjera që preken ose ka të ngjarë të preken nga projekti (palët e prekura nga projekti), si dhe individë, grupe ose subjekte të tjera që kanë interes në projekt (palë të tjera të interesit).

4.1. Palët e prekura

Palët e prekura (ose **përfituesit kryesorë**) përfshijnë grupet ose individët e mëposhtëm:

- **Zyrtarët publikë:** Ky projekt përfshin bashkëpunimin me institucionet përkatëse publike dhe përfshirjen e zyrtarëve publikë në aktivitetet e projektit si kërkimi dhe analitika, ngritja e kapaciteteve për nxjerrjen dhe përdorimin proaktiv të të dhënave për klimën dhe energjinë, dialogun me shumë palë të interesit për të bashkë-projektuar zgjidhje në forume, diskutime, tryeza të rrumbullakëta, konferenca të ndryshme, si dhe aktivitete të ndryshme komunikimi dhe informimi të publikut. Institucionet publike dhe zyrtarët publikë do të jenë objektivat kryesore të aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të këtij projekti për rëndësinë e të dhënave për subjektet publike, qytetarët, shoqërinë civile dhe korporatat për të marrë vendime të informuara dhe për të kontribuar në Agjendën e Gjellbër. Si rezultat, zyrtarët publikë mund të marrin vendime më të mira të bazuara në të dhëna dhe të propozojnë politika dhe ndërhyrje më të përshtatshme të tranzicionit të gjellbër. Disa entitete publike janë para-identifikuar si partnerë natyrorë të projektit për shkak të mandateve të tyre në çështjet e energjisë dhe mjedisit, duke përfshirë Departamentin e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe Departamentin e Energjisë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Zyrës së Kryeministrit. Projekti do të shënjestrojë si vendimmarrësit ashtu edhe stafin teknik në këto institucione. Konfirmimi dhe identifikimi i mëtejshëm i homologëve të qeverisë do të bëhet gjatë Vlerësimit të Nevojave në fazën fillestare të projektit (shih aktivitetin 1 nën komponentin 1).
- **OSHC-të dhe mediat:** Ky projekt synon OSHC-të, si dhe organizatat tradicionale mediale (TV, gazeta, revista) duke ofruar analiza të sakta dhe të kohshme të performancës së qeverisë në tranzicionin e gjellbër dhe ngritjen e kapaciteteve për përdorimin e të dhënave klimatike dhe energjetike për të lehtësuar një angazhim të bazuar në prova me publikun dhe hisedarët kryesorë.

- **Të rinjtë:** Për tu siguruar që zëri i rinisë reflektohet në dialogun e tranzicionit të gjelbër dhe vendimmarrjen nga subjektet qeveritare, theksi do të jetë në punën me të rinjtë dhe rritjen e ndërgjegjësimit për klimën, ndërtimin e kapaciteteve dhe aktivitetet e angazhimit qytetar. Ky propozim synon të rinjtë anembanë Kosovës me theks të veçantë tek të rinjtë që jetojnë në zonat më të prekura, siç janë pikat e nxehta mjedisore ose në afërsi të minierave të qymyrit.

4.2. Palët tjera të interesit

Palët tjera të interesit përfshijnë grupet ose individët e mëposhtëm:

- **Publiku/qytetarët në përgjithësi:** Projekti do të përfitojë publikun duke rritur qasjen e qytetarëve në informacion dhe proceset qeveritare që lidhen me zbatimin e Agjendës së Gjelbër. Kuptimi i zgjeruar i alternativave të politikave dhe implikimeve të tyre krijon një mjedis të përshtatshëm për qytetarët që të bëhen agjentë të ndryshimit duke kërkuar më shumë transparencë, llogaridhënie dhe vëmendje ndaj prioritetëve të tyre në tranzicionin e energjisë së pastër.

4.3. Individë ose grupe të pafavorizuara/cenuara

Grupet e marginalizuara dhe cenuara. Grupet ose individët e cenuar/të pafavorizuar janë pjesëtarë të komunitetit të cilët, si rezultat i faktorëve të shumtë (p.sh. moshë, gjinia, raca, përkatësia etnike, feja, aftësia e kufizuar fizike, mendore ose tjetër, gjendja shëndetësore, orientimi seksual, identiteti gjinor, disavantazhet ekonomike, etj.) mund të jenë më të kufizuar se të tjerët në aftësinë e tyre për të përfituar nga beneficionet e projektit. Ata në veçanti mund të përballen me vështirësi në pjesëmarrjen në proceset e angazhimit të palëve të interesit dhe kështu mund të mos jenë në gjendje të shprehin plotësisht opinionet dhe/ose shqetësimet e tyre në lidhje me aktivitetet e propozuara të projektit. Për të shmangur këtë, konsorciumi implementues do të marrë masa konkrete për të lehtësuar pjesëmarrjen e grupeve të marginalizuara (duke u fokusuar veçanërisht tek gratë, të rinjtë që banojnë në zonat rurale, të rinjtë nga grupet e pakicave etnike, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe individët me shëndet të ndjeshëm) në proceset vendimmarrëse dhe të angazhimit të palëve të interesit, si dhe të sigurohet që nevojat e tyre të merren parasysh në mënyrë adekuate gjatë zbatimit të aktivitetit të projektit. Këto masa janë paraqitur më konkretisht në Tabelën 1 më poshtë.

Për më tepër, një nga synimet kryesore të projektit është të sigurojë të dhëna më të qasshme, më të përshtatshme për përdoruesit dhe të standardizuara për çështjet e klimës/energjisë duke i paraqitur ato përmes info-grafikët dhe platformave interaktive të të dhënave. Pra, të gjitha publikimet e projektit si info-grafikët, video animacionet, punimet kërkimore, etj. do të marrin në konsideratë nevojat e komunikimit dhe angazhimit të grupeve të marginalizuara. Për shembull, për t'iu përshtatur nevojave specifike gjuhësore, i gjithë materiali i prodhuar ose i publikuar në lidhje me projektin do të jetë në dispozicion në shqip, anglisht dhe serbisht (tri gjuhët zyrtare në Kosovë).

Tabela 1: Masat e përshtatura të angazhimit të palëve të interesit (individë ose grupe të pafavorizuara/cenuara)

Grupi i palëve të interesit	Kufizimet e angazhimit	Masat/Burimet për të lehtësuar angazhimin
Gratë dhe vajzat	<ul style="list-style-type: none"> ● Si rezultat i normave diskriminuese të 	<ul style="list-style-type: none"> ● Në info-grafika dhe video animacione do të përdoren maksimalisht personazhet gra si

	<p>bazuara në gjini, mund të mendojnë se angazhimi i tyre nuk është i rëndësishëm apo i nevojshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Mund të ndihen në siklet për të marrë pjesë në ngjarje publike dhe/ose për të ndarë pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre para burrave ● Përgjegjësitë familjare mund ta bëjnë të vështirë pjesëmarrjen në ngjarje që janë larg shtëpisë të tyre ose që janë planifikuar për një kohë të caktuar 	<p>përdoruese të platformës</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Lehtësueset gra mbajnë trajnime për ngritjen e kapaciteteve ● Nëse është e nevojshme, organizohen ngjarje/sesione të veçanta konsultimi vetëm me gratë ● Vendet e konsultimeve publike janë afër shtëpive të atyre angazhimi i të cilëve kërkohet ● Koha e konsultimeve nuk do të ndërhyjë në punët e shtëpisë/familjes ● Sigurimi i shpërndarjes së informacionit të projektit përmes kanaleve të shumta duke përfshirë radion, mediat sociale, gojë më gojë, duke përfshirë materiale audio-vizuale për ata që nuk dinë shkrim-lexim.
Përfituesit (dhe veçanërisht të rinjtë) që banojnë në zona të largëta/rurale	<ul style="list-style-type: none"> ● Sfidat e transportit (p.sh. pamundësia për të përballuar kostot e transportit për pjesëmarrjen në ngjarje/aktivitete të caktuara të projektit) 	<ul style="list-style-type: none"> ● Mbulohen kostot e transportit për pjesëmarrësit ● Komunikimi online
Të rinjtë nga grupet e pakicave etnike	<ul style="list-style-type: none"> ● Mund të ndihen të padëshiruar për të marrë pjesë në ngjarje (frika nga diskriminimi) ● Mund të ndihen të nënpërfaqësuar për sa i përket barrierave gjuhësore 	<ul style="list-style-type: none"> ● Komunikimi me Drejtoritë Komunale të Arsimit për të siguruar komunikim të duhur të shënjestruar me qëllim të informimit të tyre mbi aktivitetet e projektit dhe lehtësimin e pjesëmarrjes ● Organizimi i sesioneve informuese gjithëpërfshirëse në shkolla ● Sigurimi që të gjitha thirrjet për aplikim të jenë gjithashtu të disponueshme në gjuhët përkatëse
Të rinjtë me aftësi të kufizuara	<ul style="list-style-type: none"> ● Sfidat që lidhen me qasjen në vendtakime ● Formati i materialeve 	<ul style="list-style-type: none"> ● Sigurimi që objektet për konsultime/ngjarje të angazhimit të jenë të qasshme ● Materialet prodhohen në një format të qasshëm për të gjithë audiencën dhe duke përdorur një sërë qasjesh audio-vizuale (të shkruara, radio, televizion, media sociale etj.; përdorimi i interpretuesve të gjuhës së shenjave kur nevojiten)

		<ul style="list-style-type: none"> ● Trajnimet e ofruara janë të qasshme ● OJQ-të lokale dhe/ose grupet joformale mund të angazhohen për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit.
Individë me shëndet të ndjeshëm	<ul style="list-style-type: none"> ● Sfidat që lidhen me aftësinë e tyre (për shkak të problemeve shëndetësore) për të marrë pjesë në ngjarje dhe aktivitete të projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ● Krijimi i materialeve të veçanta për të adresuar nevojat e tyre ● Sigurimi i shpërndarjes së informacionit të projektit përmes kanaleve të shumta online; organizimi i ngjarjeve/konsultimeve virtuale

Tabela 2 më poshtë kategorizon palët e interesit të identifikuar bazuar në:

1. Shkallën e rëndësisë, d.m.th. kush do të humbasë ose do të përfitojë ndjeshëm nga projekti;
2. Shkallën e ndikimit, d.m.th. veprimet e kujt mund të ndikojnë potencialisht në suksesin e projektit.

Tabela 2. Analiza e palëve të interesit bazuar në ndikimin dhe rëndësinë

	Ndikim i lartë	Ndikim i ulët
Rëndësi e lartë	<p>Kategoria A: Të angazhuar për së afërmi</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Ministritë përkatëse të linjës: Ministria e Ekonomisë; Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ● Zyrtarët publikë nga institucionet publike të shënjestruara në nivel kombëtar ● Qytetarët dhe komunitetet që janë më të goditur/prekur nga çështjet e energjisë/klimës ● Organizatat lokale të shoqërisë civile, veçanërisht ato që punojnë në sektorët e klimës dhe energjisë ● Mediat dhe gazetarët ● Zyra e Kryeministrit (ZKM) 	<p>Kategoria B: Të përfshirë</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Të rinjtë dhe nxënësit nga shkollat e mesme publike, duke përfshirë nxënësit nga familjet me të ardhura të ulëta, zonat rurale, PWD, pakicat etnike ● Publik i gjerë ● Agjencitë shtetërore si: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale; Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE); Operatori i Transmisionit (KOSTT) ● Akademia, duke përfshirë institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat; ekspertë të fushës ● Parlamenti (Kuvendi) i Kosovës

		<ul style="list-style-type: none"> ● Organizatat ndërkombëtare të angazhuara në fushën e energjisë dhe klimës
Rëndësi e ulët	<p>Kategoria C: Të mbahen të informuar dhe të konsultohen</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Ndërmarrjet publike si Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ● Kompania private e shpërndarjes së energjisë (KEDS) ● Institucionet financiare vendase dhe ndërkombëtare 	<p>Kategoria D: Të mbahen të informuar</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Institucionet e vetëqeverisjes lokale (komunat) ● Ministritë tjera të qeverisë, si Ministria e Zhvillimit Rajonal ● Shoqatat e biznesit si odat ekonomike, Shoqata e Energjisë së Ripërtërishme të Kosovës etj. ● Sindikatat ● Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKM)

4.4. Përmbledhje e nevojave të palëve të interesit në projekt

Tabela 3. Nevojat e palëve të interesit në projekt

Grupi i palëve të interesit	Karakteristikat kryesore	Nevojat gjuhësore	Mjetet e preferuara të njoftimit/konsultimit	Nevojat e veçanta (qasja, shtypja me shkronjat e mëdha, kujdesi për fëmijët, takimet gjatë ditës)
Ministritë e linjës/zyrtarët kryesorë qeveritarë	Politikëbërësit që mbledhin të dhëna në lidhje me klimën dhe energjinë	Gjuhët zyrtare	Takime, e-maila, faqe interneti, telefon, korrespondencë zyrtare (letra dhe kërkesa), raporte progresi	Takime të rregullta zyrtare gjatë orarit standard të punës për ministritë dhe institucionet lokale (08:00-16:00)
OSHC-të	Të specializuara në fusha specifike dhe shumë të zëshme në mbrojtjen e çështjeve të komunitetit	Gjuhët zyrtare	Faqe të internetit, e-maila, telefon, takime	Takime formale dhe joformale; takimet pas punës
Mediat dhe gazetarët	Shumë të fuqishëm në vendosjen e opinionit publik; kompetent në monitorimin e institucioneve qeveritare	Gjuhët zyrtare	E-maila, telefon, faqe interneti, media sociale, takime	Takimet pas punës; takimet e fundjavës
Të rinjtë	Të rëndësishëm për të ardhmen e tranzicionit të gjelbër; aktivë në fuqinë punëtore	Gjuhët Zyrtare; gjuhë e duhur dhe e përshtatur për moshën; materiale miqësore për të rinjtë	Media sociale, telefon, e-maila, faqe interneti, fokus grupe/takime, aktivitete informuese, sesione informative në internet (punëtori), materiale promovuese, MA	Takimet pas shkollës; ngjarjet e fundjavës; pëlqimi i prindërve për aktivitete specifike
Institucionet tjera publike (p.sh. agjencitë publike)	Njohuri dhe ekspertizë në çështjet e lidhura me energjinë/klimën; grupe të dhënash për energjinë dhe klimën	Gjuhët zyrtare	E-maila, telefon, faqe interneti, kërkesa zyrtare, raporte progresi	Takim formal në ambientet e institucioneve publike; aranzhime paraprake të takimeve.

Grupe joformale të qytetarëve	Angazhimi i organizatave me bazë në komunitet me përfshirje të drejtpërdrejtë të qytetarëve; interesim i lartë për të përmirësuar komunitetin e tyre lokal	Gjuhët Zyrtare; përshtatur me nivelet e shkrim-leximit (materiale të lehta për t'u lexuar)	Telefon, media sociale, letra, materiale promovuese (fletëpalosje, broshura, etj.), faqe interneti, takime, MA	Takime formale dhe joformale zakonisht pas orarit të punës dhe në fundjavë; Takimet do të zhvillohen në terren.
Organizatat Ndërkombëtare	Ndikojnë në agjendën e qeverisë dhe ofrojnë stimuj financiarë për ndërhyrje të caktuara	Anglisht	E-maila, telefon, faqe interneti, korrespondencë zyrtare	Komunikimi/takimet online dhe offline
Shoqatat e biznesit dhe sindikatat	Ofrojnë të dhëna se si legjislacioni/të dhënat e lidhura me energjinë dhe klimën ndikojnë në praktikën e tyre të biznesit	Gjuhët zyrtare	Takime, faqe interneti, e-maila, postime në rrjetet sociale, telefon	Takime të rregullta zyrtare gjatë orarit standard të punës (08:00-16:00); agjenda e detajuar e takimit e shpërndarë paraprakisht
Akademia/ Ekspertë të fushës	Mund të ndajnë njohuritë e tyre mbi çështjet e lidhura me energjinë dhe klimën dhe të propozojnë ndërhyrje; mund të llobojnë për përfshirjen e kurrikulave të lidhura me energjinë dhe klimën në programet e mësimi	Gjuhët zyrtare	Takime, faqe të internetit, e-maila, telefon	Takim formal në ambientet e institucioneve publike; aranzhime paraprake të takimeve
Asociacioni i Komunave të Kosovës	Mund të ndikojnë në përshtatjen e legjislacionit të vendit si dhe të shtyjnë komunitat e caktuara të ofrojnë të dhëna lidhur me energjinë/klimën	Gjuhët zyrtare	Takime, faqe të internetit, e-maila, telefon	Takime të rregullta zyrtare gjatë orarit standard të punës (08:00-16:00); aranzhime paraprake të takimeve, vizitat në vendngjarje

5. Programi i angazhimit të palëve të interesit

5.1. Qëllimi dhe koha e programit të angazhimit të palëve të interesit

Qëllimi kryesor i këtij programi të angazhimit të palëve të interesit është të krijojë një proces të hapur, gjithëpërfshirës dhe transparent të angazhimit dhe komunikimit ndërmjet të gjithë aktorëve të projektit, veçanërisht me qëllim të koordinimit të përpjekjeve për të përshtatur politikëbërjen e mbështetur nga të

dhënat. Më konkretisht, ky program synon të bashkojë institucionet qendrore, lokale dhe ndërkombëtare, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, qytetarët dhe rininë në veçanti, në një përpjekje të përbashkët për të përmirësuar çështjet mjedisore dhe klimatike në Kosovë.

Të gjithë aktorët e identifikuar të projektit do të informohen me kohë për qëllimet, objektivat, aktivitetet e projektit, si dhe për mekanizmat e zgjidhjes së ankesave. Po ashtu, informacionet mbi analizat dhe hulumtimet e kryera do t'u shpërndahen rregullisht të gjitha palëve të interesit, siç përshkruhet në Strategjinë e shpërndarjes së informacionit.

Gjatë gjithë zbatimit të projektit, palët e interesit do të informohen dhe do të ftohen të marrin pjesë në konsultime përkatëse, veprime për ndërtimin e kapaciteteve, diskutime dhe ngjarje të tjera specifike (p.sh. forume të gjelbra, konferenca, debate, etj.). Komiteti Drejtues i përbërë nga përfaqësues nga konsorciumi i OSHC-ve, institucionet publike partnere (ME ose MESPI), ekipi i Bankës Botërore/GPSA dhe donatorët përkatës, do të shërbejë si organ kryesor koordinues përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e angazhimit të palëve të interesit dhe për të siguruar që komentet e tyre janë marrë në konsideratë dhe adresuar në mënyrë adekuate gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. Takimi i parë i Komitetit Drejtues pritet të mbahet përpara fillimit të projektit, i ndjekur nga takimet e rregullta vjetore.

Konsorciumi do të përpiqet të forcojë lidhjet midis palëve kryesore të interesit gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit duke iniciuar dhe mbështetur dialogun dhe komunikimin e rregullt përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, dhe veçanërisht përmes shërbimit të gjitha në një vend, "One-stop shop", të krijuar nga projekti në platformë digjitale. Përmes platformës, të gjitha palët e interesit (përfshirë zyrtarët publikë, OSHC-të, mediat, të rinjtë dhe publikun e gjerë) fillimisht mund të "luajnë" me të dhënat dhe të marrin informacione të përditësuara për mjedisin, energjinë dhe Agjendën e Gjelbër të Kosovës, dhe mund të përdorin funksionin "pyet shtetin" për të kërkuar qasje shtesë në informacione/dokumente publike.

Me fjalë të tjera, platforma online do të shërbejë si një qendër kryesore bashkëpunimi/angazhimi me palët e interesit, e cila do të sigurojë a) informacione dhe grupe të dhënash lehtësisht të qasshme dhe të kuptueshme për energjinë dhe klimën, b) ndërveprim kuptimplotë midis qytetarëve dhe zyrtarëve qeveritarë dhe c) një qasje ndërvepruese për të kuptuar dhe përdorur të dhënat.

5.2.Strategjia e propozuar për shpalosjen e informatave

Gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit, organizatat implementuese do të shpalosin me kohë informatat mbi objektivat e projektit, komponentët, qëllimet, aktivitetet dhe proceset e tjera për palët e interesit të synuara siç përshkruhet në Tabelën 4 më poshtë.

Shpalosja e informatave parashikohet të bëhet në të gjitha fazat e projektit (në fillim të projektit, gjatë zbatimit, si dhe në fund). Mekanizmat e shpalosjes së informatave përfshijnë një kombinim të takimeve sy-me-sy (aty ku është e aplikueshme), komunikimit me shkrim (siç janë dokumente kërkimore, artikuj, e-maila dhe raporte progresi), reklama në radio dhe podkaste, reklama, video dhe info-grafikë në TV, si dhe publikime në faqet e internetit dhe mediat sociale.

Tabela 4: Strategjia e propozuar për shpalosjen e informatave

Faza e projektit	Lista e informatave që duhet të shpalosen	Metodat e propozuara	Palët e synuara të interesit	Përgjegjësitë
Fillimi i projektit	<p>Analiza e vlerësimit të nevojave që përmban të dhëna për çështjet e lidhura me klimën/energjinë në Kosovë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● Publikimet në faqet e internetit ● Postime në media sociale ● Diskutime në tryeza të rrumbullakëta me palët e interesit ● Paraqitjet në TV dhe Radio 	<p>Zyrtarët publikë, OSHC-të, mediat, të rinjtë dhe publiku i gjerë</p>	<p>Zyrtari për PR & komunikim; menaxheri i programit</p>
Implementimi	<p>Informacion në lidhje me kërkimin dhe analizën e kryer, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Rezultatet nga vlerësimi i nevojave ● Do të hartohet projekt-plani i metodologjisë së bashku me përfaqësuesit e këshillave lokal ● Rekomandime kërkimore ● Të dhëna në lidhje me mjedisin, energjinë, investimet, çështjet ligjore, procedurale dhe sociale ● Legjislacioni aktual dhe zotimet e QK-së ndaj Agjendës së Gjelbër; ● Ndarja e tregimeve me të dhëna (publikimi i 	<ul style="list-style-type: none"> ● Takime/ngjarje publike ● Përmbajtje digjitale duke përfshirë video animacione, info-grafikë, transmetime të drejtpërdrejta, paraqitje në TV dhe radio ● Publikime në platformën online duke përfshirë artikuj dhe punime kërkimore/analiza, video animacione, info-grafikë, set të dhënash të papërpunuara 	<p>Zyrtarët publikë, OSHC-të, mediat, të rinjtë dhe publiku i gjerë</p>	<p>Zyrtari për PR & komunikim; menaxheri i programit, koordinator i projektit</p>

	3 shkrimeve)			
Implementimi	Lansimi i platformës, duke përfshirë informacionin mbi qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të saj	<ul style="list-style-type: none"> • Përbajtje digjitale duke përfshirë video animacione, info-grafikë dhe doracaku i përdorimit, të shpërndara përmes rrjeteve sociale • Paraqitjet në TV dhe Radio • Komunikata për shtyp 	Zyrtarët publikë, OSHC-të, mediat, të rinjtë dhe publiku i gjerë	Zyrtari për PR & komunikim; menaxheri i programit, koordinator i projektit
Zbatimi	Thirrje/Informata në lidhje me pjesëmarrjen në aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve të projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutime/takime personale (me zyrtarë) • Postime në media sociale • Listat për dërgim të e-mailave 	Zyrtarë të ministrive përkatëse të linjës, gazetarë/media, OSHC dhe rinia	Zyrtari për PR & komunikim; menaxheri i programit, koordinator i projektit
Zbatimi	Instrumentet M&S (ESCP, SEP, MA)	<ul style="list-style-type: none"> • Publikime në faqet e internetit • Postime në media sociale • Punëtori/sesione informative 	Ministritë dhe zyrtarët përkatës të linjës	Zyrtari për PR & komunikim; menaxheri i programit
Rishikimi dhe monitorimi në mes dhe në fund të projektit	Informata mbi rezultatet e projektit, ndikimet dhe mësimet e nxjerra	<ul style="list-style-type: none"> • Takime të rregullta mujore të komitetit drejtues dhe të menaxhimit të brendshëm për të diskutuar progresin e projektit dhe mësimet e nxjerra • Raportet vjetore të monitorimit të projektit të publikuara në ueb faqen e projektit, të ndara edhe me 	Ministritë relevante të linjës	Specialist i monitorimit dhe vlerësimit të jashtëm, MEL i brendshëm dhe menaxher i projektit

		partnerët kryesorë me e-mail <ul style="list-style-type: none"> ● Postime në media sociale ● Forume të gjelbra ku do të prezantohen rezultatet/ndikimet kryesore 		
--	--	---	--	--

5.3. Strategjia e propozuar për konsultim

Organizatata zbatuese do të përdorin një sërë kanalesh për të komunikuar me palët e interesit në Projekt.

Tabela 5: Strategjia e propozuar për konsultim

Me kënd	Qëllimi	Metoda e përdorur	Përgjegjësitë
Partnerët e Projektit (BGF, ODK, FOL)	Koordinimi, zbatimi dhe monitorimi i aktiviteteve dhe intervenimeve të projektit; Ndarja e informacionit dhe rishikimeve	Komunikimi zyrtar, takime të rregullta të drejtpërdrejta, e-maila, seanca pune, monitorim dhe raporte progresi,	Ekipi i Projektit GPSA,
Anëtarët e Komitetit Drejtues: Shoqëria Civile, Qeveria (ME dhe MESPI), Komuniteti i Donatorëve	Konsultimet për aktivitetet dhe intervenimet e projektit	Takime të rregullta mujore, e-maila	Specialist i monitorimit dhe vlerësimit të jashtëm të ekipit të projektit GPSA
Zyrtarë qeveritarë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Ekonomisë	Finalizimi dhe nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit, ftesa për të marrë pjesë në studimin e vlerësimit të nevojave (nëpërmjet anketave), konsultime mbi monitorimin, metodat e kërkimit dhe setet e të dhënave	Komunikime zyrtare, e-maila, takime, anketa	Ekipi i projektit GPSA
Institucionet dhe zyrtarët publike, OSHC-të, komunitetet e prekura	Të sigurohet kontributi i tyre në analizën e gjendjes në sektorin e energjisë dhe klimës, duke përfshirë kornizën ligjore	Takime të drejtpërdrejta, intervista, pyetësorë, hulumtime në tavolinë	Ekipi hulumtues i GPSA-së
Institucionet publike dhe zyrtarët, OSHC-të, komunitetet e prekura	Diskutim mbi gjetjet e analizës së kryer të situatës (veçanërisht për nevojat dhe kufizimet e institucioneve publike në lidhje me përdorimin e të dhënave)	Takime të drejtpërdrejta, ngjarje publike, diskutime në panel	Ekipi i projektit GPSA

Akademia dhe ekspertë të fushës	Sigurimi i kontributit nga specialistët e fushës	Takime personale ose virtuale, e-maila	Ekipi i projektit GPSA
Institucionet publike dhe zyrtarët, OSHC-të, rinia, mediat, publiku i përgjithshëm/qytetarët	Ndarja e informatave mbi Platformën Online dhe setet e të dhënave të disponueshme, qëllimin dhe rëndësinë e saj, mënyrën e përdorimit të saj dhe mënyrën e paraqitjes së ankesave (MA)	Forume të Gjelbër, postime në media sociale, artikuj në ueb faqe, e-maila, video, info-grafikë, MA	Ekipi i projektit GPSA
Zyrtarë publikë dhe gazetarë	Rritja e ndërgjegjësimit për aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve të projektit (trajnime për zyrtarë publikë dhe gazetarë); Sigurimi i pjesëmarrjes së tyre në trajnim	E-maila, thirrje të hapura, takime, postime në mediat sociale	Ekipi i projektit GPSA
Të rinjtë (nxënësit), shkollat	Kryerja e komunikimit me publikun dhe sigurimi i pjesëmarrjes së tyre në debate	Thirrje të hapura, sesione informative (p.sh. nëpërmjet takimeve, prezantimeve në shkolla, ngjarjeve të transmetimit të drejtpërdrejtë në faqet e mediave sociale, etj.), postime, video/animacione për të promovuar pjesëmarrjen	Ekipi i projektit GPSA
Publiku i gjerë	Rritja e vizibilitetit të projektit dhe veçanërisht e vizibilitetit dhe përdorimit të platformës; promovimi i aktiviteteve të përgjithshme të projektit, ndikimin dhe rezultatet	Video, info-grafikë, postime në media sociale, seri në podkaste, reklama në TV dhe radio, konferenca shtypi, ngjarje publike	Ekipi i projektit GPSA

Komunitete dhe shkolla të prekura nga punimet e instalimit të paneleve diellore	Ndarja e informatave për punët e planifikuara, ndikimet e mundshme negative (p.sh. pluhuri, ndotja, zhurma), procedurat e MA	Ngjarje/prezantim informativ, takime me komunitetin, postime në media sociale, postime në ueb faqe, fletëpalosje dhe/ose postera në objektet lokale (p.sh. shkolla, zyra komunale), MA	Ekipi i projektit GPSA / Specialist i BB M&S
Punëtorët e drejtpërdrejtë dhe të kontraktuar	Sigurimi i respektimit të standardeve të M&S dhe një Kodi të Sjelljes (p.sh. sigurimi që ata janë të informuar për masat parandaluese dhe zbutëse të SEA/SH)	Takime dhe punëtori (dhe trajnime nëse është e nevojshme), pako me informata për pjesëmarrësit, MA	Ekipi i projektit GPSA / Specialist i BB M&S
Grupet/komunitetet e cënueshme (p.sh. të rinjtë e pakicave etnike, të rinjtë në zonat rurale, vajzat, personat me aftësi të kufizuara)	Rritja e ndërgjegjësimit, ofrimi i konsultimeve dhe sigurimi i reagimeve; Sigurimi i pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet e projektit	Fushata për komunikim me publikun, konsultime personale, takime me prindër, postime në mediat sociale, MA (të gjitha komunikimet duhet të marrin parasysh nevojat specifike, siç janë nevojat gjuhësore, nevojat e aftësisë së kufizuar, etj.)	Ekipi i projektit GPSA, bashkëpunimi me grupet joformale dhe OJQ-të që punojnë me këto grupe

5.4. Strategjia e propozuar për të inkorporuar pikëpamjet e grupeve të cënueshme

Siç përshkruhet në seksionin 3.3, çdo organizatë implementuese do të sigurojë që individët, grupet ose komunitetet e pafavorizuara dhe të cënueshme të konsultohen në mënyrë të kuptimplotë dhe të përfaqësohen në mënyrë adekuate. Përveç përdorimit të mekanizmave të përshtatura të angazhimit, pikëpamjet, shqetësimet dhe çështjet e tjera të ndërlidhura nga grupet e cënueshme mund të adresohen drejtpërdrejt përmes platformës, qoftë drejtpërdrejt në ministrinë e linjës ose në ekipin e menaxhimit të projektit.

Për më tepër, diskutimet publike dhe ngjarjet e tjera publike do të shërbejnë si thirrje për angazhim dhe shprehje të pikëpamjeve nga të gjithë qytetarët, përfshirë grupet e cënueshme. Organizatat e projektit do të sigurojnë që të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet e projektit (si trajnimet, forumet, debatet, etj.) të marrin në konsideratë nevojat specifike të grupeve/individëve të cënueshëm siç përshkruhet në Tabelën 1 dhe do të organizohen në ndërtesa dhe ambiente të qasshme fizikisht.

Secili nga partnerët e projektit do të mbajë kanale për MA për t'i lejuar përfituesit të paraqesin çdo reagim mbi projektin tek zbatuesit. Komiteti drejtues, përmes takimeve të rregullta të brendshme të ekipit të menaxhimit të projektit, do të diskutojë dhe vendosë për zgjidhjen e ankesave të pranuar dhe/ose komenteve/inputeve dhe do t'ua komunikojë në mënyrë efektive këto vendime palëve të prekura.

5.5. Plani kohor

Takime të rregullta mujore të menaxhimit të brendshëm do të organizohen për të planifikuar aktivitetet,

për të diskutuar progresin e projektit dhe për të diskutuar/zgjidhur çdo çështje të mundshme që mund të paraqitet gjatë rrugës. Për çdo takim do të caktohet një person që mban procesverbalin; procesverbalet e takimeve do të përpilohen dhe do të jenë në dispozicion për rishikim të brendshëm sipas nevojave të zbatimit të projektit (në varësi të çështjes/komentit të marrë). Sipas nevojës, këto procesverbale do të ndahen edhe me palët kryesore të interesit (p.sh. ministritë e linjës). Më poshtë është paraqitur plani kohor i aktiviteteve kyçe të angazhimit të palëve të interesit në përputhje me aktivitetet e projektit:

- Konsultimet për aktivitetet e projektit dhe ndërhyrjet me palët e interesit (zyrtarë publikët, OSHC, mediat, publiku i gjerë) fillimisht do të zhvillohen në tremujorin e parë të vitit të parë të zbatimit të projektit, për t'u pasuar nga takime të rregullta vjetore.
- Nënshkrimi i MM, përfundimi i studimit të vlerësimit të nevojave, si dhe renditja e seteve të të dhënave, do të kryhet nga fillimi i projektit deri në tremujorin e katërt të vitit të parë të zbatimit të projektit. Informacioni mbi gjetjet kryesore të studimit të vlerësimit dhe setet e të dhënave do të ndahet në përputhje me rrethanat me palët kryesore të interesit.
- Themelimi i Komitetit Drejtues do të bëhet gjatë tremujorit të parë të vitit të parë të projektit. Komiteti drejtues do të takohet rregullisht (të paktën një herë në vit ose sipas nevojave të projektit).
- Mbledhja e informacionit dhe seteve të të dhënave në dispozicion do të fillojë në tremujorin e parë të zbatimit të projektit, ndërsa në vitin e parë të projektit do të fillojë të zhvillohet edhe platforma digjitale. Platforma parashikohet të publikohet për publikun e gjerë në tremujorin e tretë të vitit të dytë. Platforma do të përditësohet dhe mirëmbahet vazhdimisht gjatë ciklit të projektit, duke përfshirë këtu shtimin/rishikimin e të dhënave dhe informacioneve të tjera në mënyrë të vazhdueshme.
- Hulumtimi mbi Zbatimin e Agjendës së Gjelbër në sektorin e energjisë dhe klimës duke përfshirë kornizën ligjore do të kryhet duke filluar nga tremujori i dytë i vitit të parë të zbatimit të projektit dhe do të finalizohet në fund të vitit, ndërsa publikimi i dytë i raportit të analizës do të bëhet deri në fund të tremujorit të tretë të vitit të tretë të zbatimit të projektit. Diskutimet e palëve të interesit mbi analizën e situatës, gjetjet kryesore, nevojat dhe kufizimet e institucioneve publike në lidhje me përdorimin e të dhënave do të organizohen pas publikimit të secilës analizë.
- Forumet e Gjelbër do të organizohen gjatë tre viteve të projektit ku progresi i bërë në vitin e kaluar në Agjendën e Gjelbër dhe identifikimi i veprimeve prioritare për klimën dhe energjinë, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve dhe të dhënave, që duhet të zbatohen në periudhën e ardhshme. Pas çdo forumi, anëtarët e konsorciumit të projektit brenda një muaji do të hartojnë Dokumentin e Përkushtimit të Forumit të Gjelbër si rezultat i forumit.
- Gjatë vitit të dytë të zbatimit të projektit, anëtarët e konsorciumit do të organizojnë një trajnim për ngritjen e kapaciteteve mbi të dhënat për zyrtarët publikë, përfaqësuesit e mediave dhe OSHC-të. Kjo ngjarje nxjerrje mësimesh do të përfshijë ngritjen e kapaciteteve mbi të dhënat për zyrtarët publikë, përfaqësuesit e mediave dhe OSHC-të, duke përfshirë shpalosjen proaktive të të dhënave për klimën dhe energjinë dhe metodat e përdorimit të informatave kthyese për të informuar politikatat publike dhe vendimmarrjen.
- Ndarja e tregimeve me të dhëna do të kryhet në vitin e dytë dhe të tretë të projektit, pas grumbullimit dhe analizimit të të dhënave në vitin e parë të zbatimit të projektit.
- Debatet me të rinjtë do të organizohen në tremujorin e fundit të vitit të parë dhe do të vazhdojnë gjatë tremujorit të parë dhe të dytë të vitit të dytë. Debatet me të rinjtë synojnë të rrisin njohuritë dhe zërin e të rinjve për tema të gjelbra lokale, me pjesëmarrjen e të rinjve në turneun kombëtar të debatit si aktivitet final. Ekipi fitues fiton çmimin e panelit diellor për shkollën e tyre, zbatim i të cilit do të bëhet gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit të dytë.

5.6 Rishikimi i komenteve

Konsorciumi do të organizojë takime të rregullta mujore të menaxhmentit të brendshëm për të shqyrtuar dhe për t'iu përgjigjur komenteve të pranuar nga palët e interesit të projektit përmes platformave ose kanaleve të ndryshme (p.sh., platforma digjitale, takime zyrtare, konsultime, Mekanizmi i Ankesave, etj.). Shënimet përmbledhëse nga çdo takim i zhvilluar (përfshirë vendimet/rezultatet) do t'u dërgohen palëve përkatëse të interesit (përfshirë qytetarët dhe grupet e cënueshme) me shkrim jo më vonë se 30 ditë pas takimit të mbajtur. Për çështje specifike, platforma digjitale do të shërbejë edhe si një qendër për shpërndarjen e informacionit/vendimeve bazuar në çështjet/komentet/informatat e kthyera të pranuar.

5.7 Fazat e ardhshme të projektit

Ky projekt parashikon një gamë të gjerë mekanizmesh raportues, duke përfshirë platformën digjitale, e cila do të shërbejë si burim kryesor i informacionit mbi të dhënat e energjisë dhe klimës, kornizat ligjore mjedisore, angazhimet e QK-së dhe progresin drejt zbatimit të Agjendës së Gjellbër, si dhe progresin e projektit dhe ndikimet. Përveç përdorimit të platformës për të mbajtur angazhimin e rregullt me aktorët kryesorë të projektit, agjencitë zbatuese gjithashtu do t'u raportojnë palëve të interesit të paktën një herë në vit (nëpërmjet monitorimit vjetor dhe raporteve të progresit) dhe më shpesh gjatë periudhave të aktivitetit të lartë.

6. Burimet dhe përgjegjësitë për zbatimin e aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit

6.1. Burimet

BGF, FOL dhe ODK do të zbatojnë drejtpërdrejt aktivitetet e caktuara për secilin në Dokumentin e Projektit. Organizatat kanë ndarë një buxhet prej afërsisht \$20,000 për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara të angazhimit të palëve të interesit (përfshirë diskutimet e analizave/gjetjeve kryesore, lansimin e platformës, trajnimin për të dhënat për zyrtarët publikë dhe gazetarët, debatet me rininë, etj.). Përveç kësaj, buxheti i ndarë për Komitetin Drejtues është i mjaftueshëm për të siguruar hapësirën dhe burimet adekuate të nevojshme për zbatimin efektiv të planit të angazhimit të palëve të interesit.

6.2. Funksionet menaxhuese dhe përgjegjësitë

Plani i angazhimit të palëve të interesit do të zbatohet, monitorohet dhe përditësohet nga Menaxheri i Projektit brenda BGF, në koordinim me koordinatorët e projektit nga dy organizatat e tjera partnere, përkatësisht FOL dhe ODK. Gjithashtu, Komiteti Drejtues do të shërbejë për të përmirësuar dhe mbështetur bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesit kryesore të identifikuara, përfshirë ministritë e linjës. Platforma digjitale do të ofrojë informacion se si palët e interesit (përfituesit parësorë dhe dytësorë) mund të kontaktojnë me individin/ët e caktuar nga SEP me çdo koment ose pyetje në lidhje me projektin ose angazhimet. Një bazë e të dhënave e projektit do të krijohet për të përfshirë të dhënat kryesore në lidhje me aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit. Informacionet për palët e interesit, pyetjet, komentet dhe të dhënat do të regjistrohen vazhdimisht dhe do të përdoren si pikë diskutimi gjatë mbledhjeve të komitetit drejtues. Kjo bazë të dhënash do të themelohet nga BGF, ndërsa ODK dhe FOL do të kontribuojnë në mënyrë aktive në të njëjtën bazë të dhënash, sipas marrëveshjes së zbatimit dhe aktiviteteve të kryera nga ODK dhe FOL.

Organizatat implementuese do të mbajnë takime mujore koordinuese për të diskutuar aktivitetet specifike për projektin; përmbledhjet e takimeve do të përgatiten në mënyrë adekuate dhe do të ndahen

me palët e interesit (ato do të publikohen edhe në platformën digjitale).

7. Mekanizmi i ankesave

Mekanizmi i ankesave të projektit (MA) do të krijohet dhe do të organizohet brenda BGF. Projekti parashikon një gamë të gjerë kanalesh për ankesa, duke përfshirë përmes platformës digjitale, e-mailit, numrave të telefonit të stafit përgjegjës të projektit dhe lokacionet fizike të zyrave të partnerëve implementues të projektit për paraqitjen e ankesave. MA do të hartohet në një mënyrë që të jetë i qasshëm, bashkëpunues, i shpejtë dhe efektiv në zgjidhjen e brengave dhe përfshin pika/kanale të shumta hyrjeje përkatëse për të dhëna që do të dorëzohen. Pjesëtarët e komunitetit, ofruesit e shërbimeve, si dhe të gjithë punëtorët e projektit (përfshirë punëtorët e kontraktuar si punëtorët e ndërtimit të angazhuar në instalimet e paneleve diellore) mund të ankohen për çdo problem që mund të hasin në lidhje me projektin (p.sh. situata e pafavorshme sociale ose mjedisore e shkaktuar nga projekti; qasje e kufizuar në shërbimet e projektit, etj.)

Pika qendrore e MA do të jetë Menaxheri i Projektit brenda BGF, përgjegjës për regjistrimin sistematik, gjurmimin, hetimin/verifikimin dhe zgjidhjen e menjëhershme të ankesave (pas diskutimeve me Komitetin Drejtues gjatë takimeve mujore) ose për qëllime të informimit dhe komunikimit të mekanizmave të ankesave tek palët e interesit, e-maili i veçantë (më vonë përmes platformës) do të promovohet në të gjitha materialet dhe gjithashtu do t'u komunikohet të gjitha palëve të interesit gjatë çdo ngjarjeje. Informacionet për kontakt për paraqitjen e një ankesë do të jetë publik dhe do të promovohet në materialet e komunikimit të prodhuara për këtë projekt. Pasi pranimit të një ankesë, Menaxheri i Projektit është përgjegjës për regjistrimin manual të saj në Regjistrin e Ankesave (bazën e të dhënave) i cili ndahet me tre organizatat zbatuese. Të gjitha ankesat e pranuar duhet të regjistrohen aty, duke përfshirë datën e regjistrimit, çështjen kryesore, procesin/hapat e zgjidhjes, statusin, etj. Baza e të dhënave do të shërbejë për të monitoruar zgjidhjen e ankesave të pranuar.

Pranimi i të gjitha ankesave do të bëhet brenda 3 ditëve dhe ato do të trajtohen brenda 30 ditëve nga marrja e tyre nga ekipi i menaxhimit të projektit të BGF. Nëse kërkohet më shumë kohë, do të kontaktohet ankuesi dhe do t'i shpjegohen arsyet për këtë dhe do të njoftohet kur mund të pritët një përgjigje e plotë. Nëse ka çështje të tjera/procese të apeleve të iniciuara, çështja në fjalë do të trajtohet në takimin mujor të partnerëve me ç'rast menaxheri i projektit (BGF) dhe koordinatorët e projektit të FOL dhe ODK do të trajtojnë ankesën/apelin. Pasi ekipet e BGF, FOL dhe ODK të dërgojnë përgjigje e tyre në ankesë dhe përsëri ka një tjetër proces apeli, atëherë çështja do të dorëzohet për diskutim në komitetin drejtues. Çdo tre muaj, partnerët e projektit do të përgatisin raporte koncize përmbledhëse mbi ankesat e pranuar (dhe të zgjidhura). Treguesit e MA që do të vlerësohen në këto raporte të MA: i) Numri i ankesave/çështjeve të regjistruara; ii) Përqindja e ankesave të zgjidhura; iii) Përqindja e ankesave të korrigjuara brenda afatit të caktuar, ose koha e nevojshme për të zgjidhur ankesat; iv) Përqindja e ankuesve të kënaqur me përgjigjen dhe procesin e zgjidhjes së ankesave. Këto raporte do të ndahen me partnerët kryesorë (si ministritë e linjës dhe BB) dhe gjithashtu do të përfshihen në raportet vjetore të monitorimit dhe progresit (seksioni i dedikuar për MA).

Projekti do të trajtojë ankesat e SEA/SH siç përshkruhet në shënimin Mekanizmat e Ankesave për SEA/SH në projektet e financuara nga Banka Botërore. Mandati i një MA të SEA/SH është i kufizuar në: (i) duke iu referuar çdo të mbijetuar që ka paraqitur një ankesë në shërbimet përkatëse, (ii) duke përcaktuar nëse pretendimi bie në përkufizimin e OKB-së për SEA/SH, dhe (iii) duke vënë në dukje nëse ankuesi pretendon se ankesa është kryer nga një individ i lidhur me një projekt të Bankës Botërore. MA SEA/SH nuk ka ndonjë funksion hetimor. Të gjitha degët e MA duhet të jenë të kujdesshme ndaj trajtimit të ankesave të SEA/SH, duke përfshirë kanale të shumta raportimi, opsionin e raportimit në mënyrë anonime, një protokoll përgjigjeje dhe llogaridhënieje duke përfshirë rrugët e referimit për të lidhur të

mbijetuarit me shërbimet e nevojshme të SEA.

Kanalet e dorëzimit të ankesave

MA mund të njoftohet lidhur me çdo ankesë duke plotësuar formularin e ankesës në kopje fizike ose në internet, ose në çfarëdo formati tjetër që zgjedh ankuesi. Formulari i ankesës është paraqitur në Aneksin 1. Çdo ankesë mund të dorëzohet me postë, telefon, e-mail ose personalisht duke përdorur të dhënat e mëposhtme për dorëzim:

Balkan Green Foundation
Për vëmendje të MA Kosovo Green Action Project
Rr. Universiteti 36/2, Prishtina 10000, Kosovë
+383 49 728 019
info@balkangreenfoundation.org

8. Monitorimi dhe raportimi

8.1. Përfshirja e palëve të interesit në aktivitetet monitoruese

Konsorciumi do të rekrutojë specialistë të jashtëm të monitorimit dhe vlerësimit me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të progresit të projektit kundrejt qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara (treguesit mbesin për t'u caktuar). Specialistët do të përpilojnë raporte vjetore të progresit, të cilët do të ndahen me palët kryesore të interesit (përfshirë Bankën Botërore) dhe do të jenë të hapur për diskutim/shqyrtim me ekipin e brendshëm të zbatimit të projektit, Komitetin Drejtues, dhe aktorët kryesorë të projektit (në veçanti ministrinë e linjës).

8.2. Raportimi tek grupet e palëve të interesit

Informacioni në lidhje me progresin e projektit, aktivitetet, ndikimin dhe aktivitetet e kryera të angazhimit të palëve të interesit do të shpërndahet përmes platformës digjitale, e-maileve, postimeve në media sociale, publikimeve në ueb faqe, video animacioneve dhe info-grafikëve, konferencave (dhe ngjarjeve të tjera publike), si dhe buletineve. Platforma digjitale online do të shërbejë si qendër kryesore për informacionet dhe reagimet e palëve të interesit, ndërsa forumet e gjelbra do të shërbejnë si platformë kryesore për raportimin dhe angazhimin e palëve të interesit. Të gjithë përfituesit mund të përdorin platformën digjitale për marrjen e informacionit të përditësuar mbi Agjendën e Gjelbër si dhe mbi statusin, procesin, aktivitetet dhe ndikimet e zbatimit të projektit. Për më tepër, monitorimi i projektit dhe raportet e progresit do të hartohen çdo vit dhe do të ndahen me palët e interesit të projektit.

9. Kërkesat për shpalosje dhe konsultim

Pasi të miratohet nga Banka Botërore, drafti i SEP do të publikohet në faqen e internetit të BGF për dy javë, i pasuar nga një konsultim publik. SEP do të publikohet në shqip, serbisht dhe anglisht së bashku me ftesat për konsultim publik. Për të siguruar një mbulim gjithëpërfshirës, ftesa për konsultim publik do të publikohet në një medium online me mbulim të gjerë kombëtar për të lejuar përfshirjen e një game të gjerë palësh të interesit në procesin e konsultimit. Kjo do t'u ofrojë palëve të interesit mundësi për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi rreziqet e projektit, ndikimet dhe masat zbutëse, dhe aktivitetet e propozuara të angazhimit të palëve të interesit dhe do t'i lejojë BGF-së të marrë në konsideratë dhe t'u përgjigjet atyre.

Ftesa do të tregojë se si mund të qaset dokumenti në konsultim, detajet e projektit, datën, orën dhe vendin e konsultimeve dhe detajet e informacionit për kontakt për komente dhe/ose pyetje.

Pasi të kenë përfunduar Konsultimet, do të përpilohet procesverbali i mbledhjeve dhe do t'i bashkëngjitet SEP-it. Procesverbali do të reflektojë komentet e pranuar, pyetjet e ngritura dhe se si ato janë përfshirë në dokumentin përfundimtar. Pjesëmarrja e palëve të interesit do të verifikohet përmes një regjistri të nënshkruar të pjesëmarrjes, e preferueshme me detaje kontakti të pjesëmarrësve dhe fotografi me leje për publikim. SEP me komentet e inkuorpuara dhe rezultati i konsultimit do të rishikohet nga BB, dhe pas Asnjë kundërshtimi përfundimtar, do të shpallet në formën e tij përfundimtare dhe do të mbahet në domenin publik gjatë gjithë kohëzgjatjes së Projektit.

SHTOJCA 1 – FORMULARI PËR PARASHTRIM TË ANKESËS

Nr. i referencës:

Emri dhe mbiemri

Shënim: ju mund të qëndroni anonim nëse preferoni ose të kërkoni që të mos zbulohet identiteti juaj tek palët treta pa pëlqimin tuaj. Në rast ankesash anonime, vendimi do të shpallet në faqen e internetit të BGF: <https://www.balkangreenfoundation.org/sq-al/>

Emri _____

Mbiemri _____

- Dua të paraqes ankesën time në mënyrë anonime
- Kërkoj që të mos zbulohet identiteti im pa pëlqimin tim Informacionet për kontakt Ju lutemi shënoni se si dëshironi të ju kontaktojmë (postë, telefon, e-mail).
- Me postë: Ju lutemi shënoni adresën postare:

Me telefon: _____

Me E-mail _____

Unë do të përcjell rezultatin në faqen e internetit pasi dua të mbetem anonim

Gjuha e preferuar për komunikim shqip serbisht Tjetër (*shkruani*)

Përshkrimi i incidentit ose ankesës (*Çka ndodhi? Ku ndodhi? Kujt i ndodhi? Cili është rezultati i problemit? Data e Incidentit/Ankesës*)

Incident/ankesë që ka ndodhur vetëm një herë (data _____)

Ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë? _____)

Ndodh në vazhdimësi (aktualisht po ballafaqohem me problemin) Çfarë do të dëshironit të ndodhte për të zgjidhur problemin?

Nënshkrimi: _____ Data: _____

Ju lutemi kthejeni këtë formular në: The Balkan Green Foundation, projekti Kosovo Green Action.